



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17, paragrafi 1, pika 7, të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit shpall

## THIRRJE

### PËR PARAQITJEN E ANALISTËVE TË TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE TË PJESËMARRËSVE NË FUSHATËN ZGJEDHORE ZGJEDHJE LOKALE 2021

Në mënyrë që të monitorohet në mënyrë efektive fushata zgjedhore e pjesëmarrësve në zgjedhjet e ardhshme lokale, KSHPK ka nevojë për angazhimin **e 5 analistëve të të dhënave**

#### **KUSHTET PËR PJESËMARRJE:**

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë ekonomistë të diplomuar ose në studime përfundimtare në fushën e shkencave ekonomike;
- Njohuri dhe punë me dokumente excell dhe word;
- Aftësi analitike dhe shkathtësi për leximin dhe analizimin e raporteve financiare;
- Njohuri themelore për punën e partive politike dhe fushatave zgjedhore;
- Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike;
- Gjatë procesit zgjedhor mos ketë angazhime pune.

#### **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë formularin "Aplikim për analist" dhe "Deklaratë" e cila është pjesë integrale e Aplikimit të cilat janë në dispozicion në ueb faqen e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit [www.dksk.mk](http://www.dksk.mk) dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në meil adresën: [izbori@dksk.org.mk](mailto:izbori@dksk.org.mk)

#### **AFATI I APLIKIMIT:**

Afati i aplikimit do të zgjasë deri të martën, **31.08.2021**.

#### **MËNYRA E ZGJEDHJES:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga persona të autorizuar në KSHPK dhe IFES, pas intervistës dhe testimit të kryer paraprakisht. Koha për kryerjen e intervistës dhe testimit do të përcaktohet në mënyrë shtesë me secilin nga kandidatët që do të plotësojë kushtet e mësipërme.

#### **OBLIGIMET E ANALISTËVE:**

- Prezencë të përditshme në ambientet e punës së KSHPK-së me orar pune të plotë;

- Analiza e të ardhurave të realizuara sipas burimeve të tyre të paraqitura në:
  - raportet vjetore nga puna e rregullt për vitin 2019 dhe 2020 e partive politike - pjesëmarrëse në zgjedhjet lokale dhe
  - raporte gjashtëmujore të donacioneve të pranuar për vitin 2019, 2020 dhe 2021
- Monitorimi ditor i ndryshimeve në llogaritë e transaksioneve të pjesëmarrësve:
  - kontrollim i shumave të paguara të donacioneve;
  - kontrollim i donacioneve të dyfishta: si në llogarinë e rregullt ashtu edhe në llogarinë zgjedhore nga i njëjti donator (person juridik ose fizik);
  - kontrollim i donatorëve me bazat e të dhënave të tjera (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Punësimit, Zyra e të Ardhurave Publike)
  - Monitorim ditor i rrjeteve sociale dhe portaleve që kryejnë reklamim politik;
  - Analiza e mjeteve të paguara nga llogaritë e transaksioneve dhe lidhja e tyre me shpenzimet e paraqitura në raportet periodike nga pjesëmarrësit;
  - Komunikim me një grup specifik të vëzhguesve në terren - dhënia e udhëzimeve për aktivitete specifike.
- Prezencë në trajnime të organizuara nga punëdhënësi.

#### **DETYRIMET E KSHPK:**

KSHPK-ja, ka detyrimet e mëposhtme ndaj analistëve të zgjedhur:

- Të lidhë kontratë për rregullimin e plotësimit të obligimeve të ndërsjella;
- Të kryejë trajnimin e nevojshëm;
- Të paguajë kompensim të njëhershme prej 25.000 denarë neto / muaj;
- Të sigurojë ambiente pune dhe pajisje kompjuterike;
- Për kompensimet e paguara, të paguajë shumën e tatimit mbi të ardhurat personale.

#### **PERIUDHA E ANGAZHIMIT:**

Periudha e angazhimit është nga 1 shtatori deri më 30 nëntor 2021, me mundësi për angazhim shtesë në fillim të vitit 2022.

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIMIN E KORRUPSIОНИТ**  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska